

Nr. 1 Regj.

Durrës, më 09. 01. 2025

Lënda: Në përgjigje të kërkesës suaj.**Emër MBIEMËR**

Në kuadër të implementimit të Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit” (i ndryshime), si dhe në referencë të kërkesës suaj, datë 07.01.2025, me objekt “Informacion mbi godinën e Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave”, e regjistruar në regjistrin e “Kërkesë/Ankesë/Përgjigje” në përputhje me nenin 8 të ligjit të sipërcituar me Nr. 1, ju informojmë për si vijon:

1- A gëzon statusin e mbrojtjes nga shteti si monument kulture godina e Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave?

Godina, ku aktualisht “Hekurudha Shqiptare” sha ka selinë, sigurisht që mbart një histori të ndërtimit të saj. Kjo godinë, daton e ndërtuar në vitin 1929 nga Italian’ t dhe ka shërbyer si Stacion Elektrik, në funksion të furnizimit me energji elektrike të qytetit të Durrësit. Në vitet 1949- 1950, u vlerësua që të adoptohej si Stacion Hekurudhor. Që nga ajo kohë, e gjërë më sot është pjesë e aseteve që “Hekurudha Shqiptare” sha posedon.

2- Cila është gjendja aktuale e kësaj godine? A pati dëmtime godina nga tërmeti i 26 nëntorit 2019?

Vlen të nënvizojmë se godina ka nevojë për investime në të gjithë strukturën e saj, por një vëmendje të veçante dhe imediate investimi merrton vend-strehimi i godinës, me qëllim eliminimin e ujëra të pranishme në të, që shkakton lagështirën, e cila evidentohet dhe në katet e tjera të ndërtesës. Akueshmëria në këtë hapësirë të godinës, nënkupton dhe mirëmbajtjen e saj, sepse sikundër kemi parashtruar, sasia e ujit në vend-strehim si dhe ndikimi i agentëve atmosferik në tërësi, luajnë një rol thelbësor në të gjithë strukturën ndërtimore të godinës.

Godina e Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave nuk pati dëmtime thelbësore dhe strukturore nga tërmeti i 26 nëntorit të vitit 2019.

3- A ka pësuar restaurim godina në pesë vitet e fundit? A ka projekt restaurimi për këtë godinë për të ardhmen dhe si vlerësohet gjendja e saj?

Godina në vitin 2015, i është nënshtruar punimeve mirëmbajtëse, që konsistojnë në fasadën e saj (suvatime, lyrje, stukime etj). Pas kësaj periudhe nuk ka patur punime të ngjashme me ato të vitit 2015, veç punimeve të lokalizuara estetike në ndërtesë. Godina ka nevojë për rikonstrukcion tërësor, në fasadë dhe pjesën e sipërme të ndërtesës (çati), si dhe në vendstrehimin e saktësuar në përgjigjen e mësipërme. Kjo godinë ka kompleksitetin e saj ndërtimor, marr shkak se dhe ndërtesa është konceptuar e ndërtuar me themele të vazhduara. Megjithatë, aktualisht nuk ka një projekt që premtonte rikthimin në identitet të godinës.

**Autoriteti publik “Hekurudha Shqiptare” Sh.A, angazhohet në garantimin e të drejtës së informimit, si garanci kushetuese dhe vepron në mbështetje të ligjit Ligjit Nr. 119/ 2014 “Për të Drejtën e informimit” dhe trajton kërkesën tuaj në përputhje me Ligjin nr. 9887 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.*

Me konsideratë!

KOORDINATORI I TË DREJTËS SË INFORMIMIT

Domeniko SINJARI